

**VENDIM**  
**Nr. 532, datë 8.7.2020**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË 2/128, ZONA KADASTRALE 8541, NJËSIA ADMINISTRATIVE GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të trullit me sipërfaqe 774 m<sup>2</sup>, katit bodrum, me sipërfaqe 74.4 m<sup>2</sup>, katit përldhes me sipërfaqe 220.7 m<sup>2</sup> dhe katit të parë 282.7 m<sup>2</sup>, të ndërtesës trekatëshe, të pasurisë 2/128, zona kadastrale 8541, Njësia Administrative Gjirokastrë, sipas hartës kadastrale dhe planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë.

2. Pjesa e pasurisë 2/128, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.


3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve të pjesës së pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**HARTE KADASTRALE**  
**(Fragment)**

|                                                                                      |  |                                       |
|--------------------------------------------------------------------------------------|--|---------------------------------------|
| <b>AGJENCIA SHTETËRORE<br/>E KADASTRËS</b>                                           |  | <b>A. IDENTIFIKIM</b>                 |
| <b>DREJTORI I PËRGJITHSHËM</b>                                                       |  | <b>ZONA KADASTRALE:</b> 8541          |
| <b>ARTAN LAMI</b>                                                                    |  | <b>INDEKSI I HARTËS:</b> GJ-H-7       |
| <b>Mësoni Kadastrës dhe Hartografisë</b>                                             |  | <b>ADRESA E PASURISË:</b> GJIROKASTËR |
| <b>Drejtor Andri PROKO</b>                                                           |  | <b>Rr.18 SHTATORI</b> P/G             |
|                                                                                      |  | <b>B. KUFIZIMET</b>                   |
|                                                                                      |  | <b>VERI:</b> 28/443                   |
|                                                                                      |  | <b>JUG:</b> 2/416_ZK 8542             |
|                                                                                      |  | <b>LINDJE:</b> 2/501                  |
|                                                                                      |  | <b>PERENDIM:</b> 2/415                |
|                                                                                      |  | <b>D.Data:</b> 26.09.2019             |
| <b>KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE</b>                                        |  |                                       |
|  |  |                                       |

## PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE

